



Народна банка
на Република Македонија



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY





Shtypi

E publikuar nga Projekti për zhvillim të EFSE (EFSE DF) Koncepti, faqosja dhe litografia: EFSE DF e financuar nga ana e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (BPRM) dhe Projektit për zhvillim të EFSE-së

© 2016 Projekti për zhvillimin e EFSE-së

Demant

Projekti për zhvillimin e EFSE DF me kujdes i kontrollon informatat të përfshira në këtë dokument. Sidoqoftë, Projekti për zhvillimin e EFSE DF nuk merr asnjë përgjegjësi dhe nuk garanton për afatin kohor, saktësinë dhe tërësinë e informatave të parashikuara në këtë dokument.

I DASHUR LEXUES!

Dëshirojmë t'ju ftojme në një „udhëtim“ të mrekullueshëm në botën e parasë!
Jemi të sigurt se do të përjetoni një eksperiencë interesante dhe magjepsëse.



NË KËTË UDHËTIM IMAGJINAR DO TË MËSONI:

- Çfarë janë paratë, roli dhe misioni i tyre?
- Historia e parasë, prej zanafillës së tyre deri më sot;
- Fakte për paratë;
- Më shumë informata për valutën kombëtare të Republikës së Maqedonisë;
- Si të dalloni kartëmonedhat e vërteta nga ato të falsifikuara.

A jeni gati të filloni udhëtimin? Kur do të arrijmë në pikën e fundit, do të zbuloni të gjitha fshehtësitë lidhur me paratë!

Andaj, le të fillojmë...

ÇFARË JANË PARATË?

Nga kohërat e hershme paratë janë të njohura si mjet i cili përdoret për këmbim ose pagesë të të gjitha llojeve të mallrave dhe shërbimeve

Ekziston një definicion për paratë që thotë se termi „para” është një emër i përgjithshëm për të gjitha llojet e kartëmonedhave dhe monedhave.



ËSHTË NJË AVENTURË E MADHE
TË UDHËTOSH NË KOHË

Për të mësuar se ku fillon tregimi për paratë, duhet të ktheheni në Kohën e gurit.

STACIONI - KOHA E GURIT

Në atë kohë njerëzit jetonin në komunitete të vogla. Për të ushtruar aktivitetet e tyre kryesore, gjuetinë dhe përpunimin e tokës, njerëzit përdornin mjete të prodhuara nga guri, duke i dhënë kësaj periudhe emrin – Koha e gurit ose Epoka e gurit. Disa ishin bujq, disa zanatçi. Për të mbijetuar, secili ka ushtruar disa aktivitete, kështu duke prodhuar çdo gjë që është e nevojshme për jetesë. Pas një kohe, njerëzit e kuptuan se nuk ishin të aftë të prodhojnë gjithçka dhe vendosën të këmbëjnë prodhimet.

Në Kohën e gurit metalet akoma nuk kanë qenë të zbuluara! Njerëzit nuk kanë përdorur kartëmonedha dhe monedha siç i përdorim ne sot. Për shembull, gjahtari dhe bujku këmbenin drithëra dhe lëkurë midis tyre, ose peshkatari dhe gjahtari këmbenin guaca dekorative dhe sëpatë prej guri. Ky këmbim i mallrave njihet si „shkëmbim“.

Njerëzit akoma e përdorin shkëmbimin edhe sot. Çfarë këmbeni ju me shokët tuaj?

Kur paraardhësit tanë mësuan të përpunojnë metalet, këmbimi i mallrave u bë shumë më i lehtë. Ari, argjendi, kallaji dhe hekuri konsideroheshin si metale me vlerë të madhe. Kështu, një bujk këmbente mallrat e tij për një shumë të caktuar të argjendit, dhe më vonë përdorte një pjesë nga ky argjend që të paguante tatimet e tij. Kështu, metalet me vlerë dhe disa objekte tjera ishin bërë „masë për vlerë“, një „mjet këmbimi“ dhe një mënyrë për të „ruajtur vlerën“.

MONEDHAT E PARA NË BOTË

Monedhat e para e kanë origjinën nga gjysma e dytë e shekullit të VII-të p.e.s, nga toka e Turqisë së sotme, nga mbretëria e lashtë Lidia. Ato ishin prej elektrumi që d.m.th përzierje natyrore e arit dhe argjendit.

STACIONI - PAIONËT



Fillimi i farkëtarisë së monedhave në territorin e Republikës së Maqedonisë daton nga fundi i shekullit të VI-të p.e.s, kur komunitetet paioniane filluan të prodhojnë monedhat e tyre të argjendit, vetëm një shekull pas paraqitjes së monedhave në botë.



Monedha më e vjetër në koleksionin numizmatik të Muzeut të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë është një monedhë fisit paonian Deroni, e farkëtuar në fillim të shekullit të V-të p.e.s.

Sundimtari i parë paonian i cili ka farkëtuar paratë e tij ka qenë Likei; ato kanë qenë të përpunuara prej argjendi. Mbretërit e fundit të Paionisë, Leont dhe Dropion kanë prodhuar monedha kryesisht prej bronzi.

STACIONI - MAQEDONIA E LASHTË

Historia e farkëtarisë së monedhave në mbretërinë e Maqedonisë fillon me Aleksandrin I, i cili ka prodhuar monedhat e veta në të cilat e ka paraqitur edhe emrin e tij. Filipi i II i Maqedonisë, është sunduesi i parë maqedonas antik i cili në vitin 345 p.e.s ka prodhuar monedhë prej ari – stater.

Farkëtaria e monedhave të Aleksandrit III të Maqedonisë, djalit të Filipit II të Maqedonisë, ka qenë një prej farkëtarive më të pasura dhe më të njohura të monedhave perandorake në histori. Paratë e tij janë prodhuar edhe pas vdekjes së tij.



STACIONI - ROMA E LASHTË



Në periudhën kur Perandoria Romake është zgjeruar, monedhat romake janë pranuar për këmbim nëpër të gjithë Evropën. Në territorin e Republikës së Maqedonisë hyri edhe denari romak. Denari është një monedhë argjendi e cila është lëshuar në qarkullim rreth vitit 211 p.e.s. Emri rrjedh nga fjala latine deni, „nga dhjetë“ që ka nënkuptuar vlerën e sajë origjinale prej 10 asesh. Emri i këtij denominimi edhe sot është mbajtur në një numër të madh vendesh të cilat asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e Perandorisë Romake duke përfshirë edhe titullin e valutës bashkëkohore maqedonase – **denarin**.

Emri i sotëm për paratë metalike – monedhat është sipas emrit të perëndeshës së lashtë romake Junona Moneta. Në tempullin e perëndeshës Junona Moneta ka pasur një farkëtari, ku 400 vite të tëra janë farkëtuar denarët romak.



Pjesa më e madhe e monedhave të cilat gjinden në Muzeun e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, rreth 12.000 shembuj janë monedha romake.

STACIONI - BIZANTI



logo



monedha

Shkronja „M“ në paratë bizantine paraqet numrin 40. Monedha e bakrit (folis) e mbretit Bizantin Justiniani II është e paraqitur në kartëmonedhën tonë prej 50 denarëve, si dhe në logon e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë.


Nëse dëshironi ti shihni këto monedha antike, vizitoni Muzeun e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Koleksioni numizmatik sot përmban rreth 22000 shembuj të parave, të cilat janë farkëtuar ose kanë qenë në përdorim në territorin e shtetit tonë duke filluar nga shekulli i VI-të para e.s dhe paraqesin koleksionin më të madh numizmatik në Republikën e Maqedonisë.



kartëmonedha

STACIONI - PARATË PREJ LETRE (KARTËMONEDHAT)

Përdorimi i monedhave zgjodhi shumë problem, por jo edhe të gjitha. Për shembull, kur njerëzit dëshironin të blejnë mallra të shtrenjta, ata kishin nevojë për sasi të madhe të monedhave. Ato ishin të rënda për tu bartur duke përfaqësuar një objektiv të lehtë për hajdutët.



*Zgjedhja ishte prodhimi
i parasë prej letre.*

Kinezët, të cilët e shpikën letrën, ishin të parët që futën paratë prej letre në përdorim. Por pas kësaj qëndron një arsye e rëndësishme - ata nuk kishin burime të mjaftueshme për të prodhuar po aq monedha prej bakri sa u nevojiteshin atyre.

Në shekullin e njëmbëdhjetë, tregtarët italian, në vend se të përdorin sasi të mëdha të monedhave, ata filluan të përdorin letra me vlerë që quheshin „bono” ose „kambiale këmbimi”. Ato kishin të vulosura hollësi për këmbimin tregtar, duke përfshirë edhe emrat e tregtarëve në dokumente. Kështu, pasi që tregtarët përdornin letra me vlerë, hajdutët mbetnin pa pre.

Pesë shekuj më vonë, argjendarët e Mbretërisë së Bashkuar filluan emetimin e letrave me vlerë. Njerëzit linin si depozita monedhat prej ari në vende të sigurta, ndërsa argjendaritë kanë dhënë certifikata me shumë të vërtetuar të depozitës. Secili u besonte argjendarëve në atë periudhë. Certifikatat e tyre filluan të përdoren si mjet për pagesë. Njerëzit e dinin se certifikatat mundet lehtë të këmben te secili argjendarë i lagjes.

Bankave u pëlqeu kjo metodë dhe filluan të emitojnë certifikata për depozitat. Në këmbim njerëzit në çdo kohë, mund të merrnin flori, argjend ose bakër. Përdorimi i këtyre certifikatave si para, rezultoi në krijimin e kartëmonedhave të cilat i përdorim sot. Këto para quhen „para përfaqësuese”.

STACIONI - DENARI MAQEDONAS

Denari maqedonas (MKD) është valuta kombëtare e Republikës së Maqedonisë e lëshuar në qarkullim më 27 prill të vitit 1992. Banka qendrore e shtetit – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë – është institucioni i vetëm që emeton denarin.

Denarët maqedonas emetohen në formë të kartëmonedhave dhe monedhave, dhe monedhave për qëllime koleksionuese.

Nga 15 dhjetori i vitit 2016 në qarkullim janë lëshuar denarë maqedonas me strukturën denominative si vijon:

KARTMONEDHA NË QARKULLIM

ANA E PËRPARME

ANA E PRAPME





Nga futja e njësisë monetare kombëtare, për herë të parë pas 20 vitesh u kry një intervenim përmes ndryshimit të strukturës ekzistuese së vlerës me futjen e dy vlerave të reja prej 200 dhe 2000 denarësh, me çka në të vërtetë është kryer rebalancim i strukturës ekzistuese të vlerave të parave në qarkullim. Në të njëjtën kohë, kartëmonedhat me vlerë prej 5000 denarësh, për shkak të vlerës së tyre të lartë nominale dhe përfaqësimit e kufizuar gjatë kryerjes së transaksioneve të parave të gatshme janë të tërhequra prej qarkullimi.

Monedhat me vlera 1,2 dhe 5 denarë (edicioni i vitit 1993) janë të përpunuara prej legurës prej bakri (8%), zinku (17%) dhe nikeli (3%).

Monedha prej 1 denari, edicioni i vitit 2016 është e përpunuar prej legura baza e së cilës është e përpunuar prej çelikut e mbuluar me legurë dy shtresore të përbërë prej bakrit dhe mesingut.

Vlerat më të larta prej 10 dhe 50 denarësh janë lëshuar në qarkullim në vitin 2008. Monedhat prej 10 denarësh janë të përpunuara prej legurës prej bakri (70%), zinku (18%) dhe nikeli (12%), dhe prej 50 denarësh bakër (62%), zink (20%) dhe nikeli (18%).

Vlerat prej 1,2 dhe 5 denarë janë më të verdha ndërsa vlerat prej 10 dhe 50 denarësh janë më të bardha, sepse përmbajnë më shumë nikeli dhe më pak bakër.

MONEDHA NË QARKULLIM



Banka Popullore ka të drejtën ekskluzive për emetim të monedhave për qëllime koleksionuese në të cilat janë prezantuar vepra artistike shpesh të përpunuara me metale të çmueshme – argjend në kombinim të gurëve të çmuar. Ata emetohen në edicione të kufizuara dhe u dedikohen „Ikonave të Shenjëtarëve“, „Shenjave të Horoskopit“, „Ditës së Engjullit“, „Ikonave të Shën Marisë“, „Shën Tereza e Kalkutës“, dhe „Kalendari Hënor“.




TRE HAPA PËR TË NJOHUR KARTËMONEDHAT TUAJA

PREKENI



- **Prekeni letrën:** Duhet të jetë e fortë.
- **Shtypi i thellë:** Ndjeni strukturën e relievit përmes prekjes së kartëmonedhës në vendin ku shfaqen fjalët „НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА“

SHIHNI



- **Kontrolloni fijen mbrojtëse:** Kontrolloni fijen e sigurisë: Duhet të shfaqet si vijë e plotë kur të ekspozohet në dritë, me tekstin e shkruar „НБРМ“ dhe vlera
- **Kërkoni filigramën:** Filigrama do të shfaqet kur kartëmonedha të vendoset përballë burimit të dritës.
- **Shihni si është shtypur:** Shtypi duhet të jetë i mprehtë dhe me ngjyra të qarta.

ANOJENI DHE KONTROLLONI



- **Anojeni** kartëmonedhën që të shihni ngjyrën metalike dhe shiritin e artë.
- **Anojeni** kartëmonedhën që të shihni se si ngjyra e fijos mbrojtëse ndryshon nga ngjyra e gjelbër në të kuqe.
- **Shihni** shtypin fluoreshent me anë të rrezatimit ultraviolet.
- **Kontrolloni** mikro-tekstin me anë të thjerrëzës.

Në vitin 2003, BPRM-ja lëshoi në qarkullim dy kartëmonedha të përmirësuara me prerje prej 500 dhe 1000 Denarë. Përmirësimet përfshijnë futjen e karakteristikave të reja të sigurisë që kanë për qëllim të zvogëlojnë rrezikun e falsifikimit të valutës kombëtare.

STACIONI - KARAKTERISTIKAT E PARASË

Të pranueshme Valuta është një mjet që duhet të pranohet nga të gjithë si mjet për këmbim dhe pagesë.

Të qëndrueshme Valuta duhet të jetë e qëndrueshme dhe të mos dëmtohet shpejt.

Të ndashme Valuta duhet të jetë në gjendje të ndërmjetësojë çdo transaksion, pa marr parasysh sa i madh ose i vogël mund të jetë.

Të njësishe Çdo valutë, ose instrument monetarë duhet të jetë prej kualitetit të njëjte dhe të jetë në gjendje të kryej funksionet e njëjta.

Mbrojtje nga falsifikimi Valuta duhet të mbrohet nga çdo lloj falsifikimi.

STACIONI - FUNSIKONET DHE FORMAT E PARASË



FORMAT E PARAVE

Gjatë gjithë historisë paratë kanë pasur më shumë forma:

1. **Mallra.** Gjatë zhvillimit historik, një numër i madh i produkteve kanë shërbyer si para. Në kohrat antike bagëtia, guacat, krypa dhe mallrat tjera janë përdorur si mjet për këmbim.
2. **Paraja metalike (monedhat).** Kjo ishte forma kryesore e parasë deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Monedhat prodhoheshin nga bakri, argjendi ose ari.
3. **Kartëmonedha (prej letre).** Ky është emër për paratë prej letre. Për herë të pare kartëmonedhat janë përdorur në Kinë në shekullin e 7-të.
4. **Paraja elektronike.** Transferi i parë telegrafik i parave është kryer në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të. Kartelat e para për pagesë janë shfaqur në SHBA në vitin 1984.

STACIONI - FAKTE TË ÇUDITSHME

Kartëmonedhat më të çuditshme në histori.

DINARËT E JUGOSLLAVISË

Në fillim të viteve 90 të shekullit XX, Republika Federale e Jugosllavisë u ballafaqua me një inflacion të pabesueshëm, që i detyroi autoritetet në vitin 1994 të emitojnë një kartëmonedhë me 11 zero – 500.000.000.000 dinarë.



TENGE E KAZAKSTANIT

Në vitin 2013, dizajni i kartëmonedhës prej 5000 Tenge (e barabartë me \$32), e fitoj titullin “Kartëmonedha e vitit” e dhënë nga Organizata Ndërkombëtare për Kartëmonedha Bankar. Ana e përparme e kartëmonedhës është e pasur me simbole të ndryshme: heronj kombëtarë, stema, rezidenca e kryetarit dhe një panterë.



PARA PREJ DRURI

Kartëmonedha prej druri janë përdorur në Amerikën Veriore në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzet.



PARA PLASTIKE

Kartëmonedha e parë prej polimeri si valutë u lëshua në qarkullim në Australi në vitin 1988, me rastin e dyqind vjetorit të imigrimit evropian në vend.



PARATË MË TË BUKURA NË BOTË

Norvegjia ka bërë një art nga dizajni i kartëmonedhave të saj. Oslo prezantoi fytyrën e re të koronave: shumë hije të ngjyrës së kuqe, portokallies dhe të verdhë. Kartëmonedhat e pazakonta janë lëshuar në qarkullim në vitin 2017.



PARATË MË TË SH TREJTA NË BOTË

Paratë, gjithashtu kanë një çmim: kartëmonedha më e shtrenjtë në botë kushton 2.225,000 dollarë amerikan.

Kartëmonedha prej 1000 dollarësh amerikan quhet „Shalqiri i madh“, (ang. Grand Watermelon) e emituar në vitin 1890 dhe i është shitur një koleksionuesi gjatë një ankandi, dhe është një prej dy kopjeve të tilla ekzistuese në botë.



LOJË PËR ARGËTIM

Monedhat kanë dizajne të ndryshme dhe mund të dallojnë sipas relievit. Deri vonë, monedhat ishin të ilustruara me fytyrat e sundimtarëve dhe zotërave të caktuar, por tani paraqesin gjëra nga më të ndryshmet. Mundohu të bësh vizatim të një monedhe: merr letër varaku ose një cope letre, vendose mbi monedhë dhe shkarra vit mbi të me laps. Çfarë fituat?





Këtu udhëtimit në botën e parasë i erdhi fundi. Ishte mbresëlënëse apo jo? Shpresojmë se informatat që keni mësuar do të ju ndihmojnë ti dalloni disa shtete sipas valutës së tyre. Mos lejoni të mashtroheni nga ndonjë falsifikim. Por mbi të gjitha, mundoheni të kuptoni cila është vlera e vërtetë e parasë. Tani ne ju lejojmë të numëroni ... jo paratë, por të gjitha gjërat e pazakonshme të cilat nuk i keni ditur më parë për paratë dhe tani janë të fiksuara në memorien tuaj.

Redaktor i publikimit: Kristina Pavleska

Lektorim: Arian Limani

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

336.741(02.053.2)(036)

UDHËTIMI në botën e parasë. - Скопје : Народна банка на Република
Македонија, 2017. - 20 стр. : илустр. ; 21 см

ISBN 978-9989-107-38-2

а) Пари - Водичи за деца
COBISS.MK-ID 105480202

